

Kompania: „Frutex“- Sh.p.k.

Fshati Novak, komuna e Prizrenit

RAPORT

I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS PËR FABRIKË PËR PRODHIM
TË PIJEVE FRESKUESE DHE TË LËNGJEVE ME BAZË FRUTASH PËR
KOMPANINË „FRUTEX“ SH.P.K. NË FSHATIN NOVAK, KOMUNA E
PRIZRENIT



Për : “FRUTEX” SH.P.K

Titulli i Projektit : Fabrikë për prodhim të pijeve freskuese dhe të lëngjeve me
bazë frutash

Ngastra kadastrale : P-71813061-00695-1, P-71813061-00693-0 dhe P-71813061-00692-0

Adresa : Novak-Prizren

Aplikuesi i Projektit: z. Shaqir Palushi; “Frutex” sh.p.k

Komuna : Prizren

Dhjetor 2022, Prizren

Kompania: „Frutex” Sh.p.k. me pronare z. Shaqir Palushi nga fshati Novakë pn, komuna e Prizrenit.

Bazuar në rregulloren e saj lëshon këtë:

A U T O R I Z I M

Autorizohet: Kompania „ALBI & B” – Shpk, e cila është e Licencuar pranë Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor si Person Juridik për Hartimin e Raporteve për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.

Për hartimin: E Raportit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis për Fabrikën “Frutex” sh.p.k, Fabrikë për prodhim të pijeve freskuese dhe të lëngjeve me bazë frutash, në fshatin Novak komuna e Prizrenit në parcelat me numër P-71813061-00695-1, P-71813061-00693-0, P-71813061-00692-0 me sipërfaqe totale S=14310m² për kompaninë „Frutex”-Shpk komuna e Prizrenit.

Investitori:

Kompania: „FRUTEX” Shpk

**z. Shaqir Palushi drejtor
Drejtor**

Hartuesi i Raportit:

Kompania „ALBI & B” Shpk

z. Albion Bytyqi ,

Djetor 2022

Raporti i VNM-së

Përmbajtja	
1. HYRJE.....	5
1.1 QËLLIMI.....	6
2. BAZA LIGJORE E PËRPILIMIT TË RAPORTIT MBI V.N.M.....	7
3. PËRSHKRIMI I LOKACIONIT DHE MJEDISIT	13
4. PËRSHKRIMI I KUSHTEVE EKZISTUESE	18
4.1 Mjedisi natyror	18
4.2 Potencialet ekzistuese	18
4.3 Relievi.....	19
4.4 Toka	20
4.5 Flora	20
4.6 Fauna	20
4.7 Ndikimi në ujëra	21
4.8 Ujërat sipërfaqësore.....	22
4.9 Ujërat nëntokësore.....	22
4.10 Peizazhi	24
4.11 Dukshmëria.....	24
5. PROCESI TEKNOLOGJIK I PRODHIMIT TË PEMËVE DHE PERIMEVE.....	27
6. IDENTIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NË MJEDIS.....	34
6.1. Ndikimet në ajër.....	35
6.2. Ndikimet në tokë	36
6.3. Ndikimet në ujë.....	37
6.4. Ndikimi në Peisazh	37
6.5. Ndikimi në florë dhe faunë.....	38
6.6. Ndikimet në vendbanime dhe popullatë.....	38
6.7. Ndikimet nga Zhurma.....	39
6.8. Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore	40
7.0. MARRJA E MASAVE PËR PARANDALIMIN DHE ZVOGËLIMIN E NDIKIMEVE.....	40
7.1. Masat e marura për mbrojtjen e ajrit	40
7.2. Masat e marura për mbrojtjen e tokës	41
7.3. Masat e marura për mbrojtjen e ujit	42
7.4. Masat për mbrojtjen e florës dhe faunës	43
7.5. Masat e marura për mbrojtjen nga zhurma	44
7.6. Masat e marura për mbrojtjen nga rreziqet aksidenciale	44
8. PROGRAMI I MONITORIMIT	44
9. RAPORTIMI	45
10. MARJA E MASAVE REHABILITUESE PAS PËRFUNDIMIT TË AKTIVITETEVE PRODHUESE	46
11. KONKLuzionET	47

1. HYRJE

Në kuadër të zgjerimit të investimeve dhe ndërtimit të objekteve të reja për linja të reja të prodhimit dhe deponimit, kompania **“Frutex” sh.p.k, Fabrikë për prodhim të pijeve freskuese dhe të lëngjeve me bazë frutash** ka paraparë edhe hartimin e raportit mbi vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe pajisjen me pelqim mjedisor të ri nga MMPHI për të gjitha objektet dhe linjat e prodhimit që i përkasin aktualisht kompleksit **“Frutex” sh.p.k.** në fshatin Novakë, komuna **Prizrenit**, përkatësisht në parcellat me numër kadastral **P-71813061-00695-1, P-71813061-00693-0 dhe P-71813061-00692-0** me sipërfaqe totale **S=14310m²**.

Me kërkesë të z. Shaqir Palushi, i cili është pronar dhe përfaqësues ligjore i kompanisë **“Frutex”- shpk Fabrikë për prodhim të pijeve freskuese dhe të lëngjeve me bazë frutash**, pasi u krye rikunjucioni i terrenit, u përgatit Raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis për aktivitetin e saj. Ky raport do të përfshijë në vete analizat e realizuara të ndikimeve të mundshme në mjedisin rrethues, duke përfshirë edhe botën e gjallë të lokacionit ku do të realizohet projekti i lartëcekur.

Hartimi i këtij raporti të vlerësimit të ndikimit në mjedis paraqet një dokument të nevojshëm dhe të domosdoshëm për paisjen e kompanisë me Pëlqim Mjedisor nga ana e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Mjedisi dhe mbrojtja e tij nuk është i rëndësishëm vetëm për njerëzit por është thelbësor dhe i nevojshëm për të gjitha qeniet në tokë. Ky raport bëhet me qëllim të përkufizimit të ndikimeve potenciale dhe caktimin e masave të cilat do të jenë të nevojshme për tu marrë për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet eventuale negative të këtij aktiviteti. Ndaj është e nevojshme që shoqëria të ndërgjegjësohet për t’a mbajtur sa më pastër mjedisin ku jetojmë duke marrë masat e duhura për trajtimin e mbetjeve si dhe emetimin e gazeve të dëmshëm në atmosferë që gjenerohen nga zhvillimi i aktiviteteve të ndryshme.

Në mënyrë që të shmangen këto probleme njerëzimi duhet të mësoj se si të menaxhohen burimet natyrore në mënyrë të qëndrueshme. Pra zhvillimi i qëndrueshëm

i burimeve natyrore nuk është gjë tjetër veçse përdorimi i tyre në mënyrë ekonomike nga brezat e sotëm për ti lënë këto burime të përdoren edhe nga brezat që do të vijnë.

Qëndrueshmëria përfshin menaxhimin e gjithë përbërësve dhe burimeve natyrore e njerëzore me qëllim që të pasurohen me kalimin e kohës dhe të sigurohet një mirëqenie për të gjithë. Zhvillimi i qëndrueshëm nuk i pranon politikat të cilat çojnë në uljen e bazës prodhuese dhe lenë gjeneratat e ardhshme me perspektiva më të ultë (të varfër) dhe/ose rreziqe me të mëdha se të koheve tona.

Ky dokument paraqet një raport të përmbledhur të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për biznesin e kompanisë “Frutex”-Shpk në fshatin Novakë komuna e Prizrenit me aktivitet prodhim të pijeve freskuese dhe të lëngjeve me bazë frutash.

Raporti përshkruan gjendjen e përgjithshme në rrethinën e lokacionit të projektit, kushtet mjedisore ekzistuese, përshkrimin teknik të projektit dhe të punimeve të cilat kryhen, ndikimet e mundshme të projektit në mjedis, si dhe masat për parandalimin apo minimizimin e ndikimeve në mjedis.

Identifikimi i ndikimeve potenciale në mjedis, identifikimi i masave për zbutjen e këtyre ndikimeve si dhe ndërmarrja e masave adekuate për të ndikuar në evitimin apo minimizimin e ndikimeve të këtij projekti në mjedis, janë komponentët kryesorë të këtij raporti. Për hartimin e këtij raporti janë përdorë të dhëna nga përshkrimi teknik i projektit si dhe të dhëna dhe materiale relevante për projekte të ngjashme.

Gjithashtu janë realizuar vizita në lokacionin e projektit, janë bërë matjet e nevojshme të lokacionit me GPS, është inçizuar gjendja e terrenit dhe janë bërë fotografi për lehtësimin e përgatitjes së këtij raporti. Raporti është punuar në bashkëpunim të ngushtë me investitorin, prej të cilit janë marrë të dhënat kryesore dhe të nevojshme përmes bisedave të drejtpërdrejta.

1.1 QËLLIMI

Procedura e marrjes së Pëlqimit Mjedisor nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, nënkupton hartimin e Raportit të Vlerësimit të ndikimit në Mjedis, me qëllim që të identifikohen dhe analizohen ndikimet në mjedis të tërë

veprimtarisë së fabrikës duke i parashtruar dhe ndërmarrë masat e domosdoshme për mbrojtjen e mjedisit në lokacionin ku ushtrohet kjo veprimtari, andaj kompania "Frutex"-Shpk në fshatin Novakë të komunës së Prizrenit ka filluar procedurat përgaditore të kompletimit të dokumentacionit të nevojshëm për t'u pajisur me pëlqimin mjedisor.

Qëllimi i investimit të këtij aktiviteti, është përgatitja e cila në bazë të qertifikatës së biznesit merret me shumë aktivitet ku bazë të aktivitetit ka prodhim të pijeve freskuese dhe të lëngjeve me bazë frutash të llojeve të ndryshme për nevoja individuale dhe tregti me shumicë dhe pakicë të organizuara për qytetarët e Kosovës, sipas standardeve Evropiane. Projektet e tilla vendore, kanë rëndësi të veçantë në ngritjen ekonomike të vendit, ofrimin e produkteve vendore me një cilësi të lartë për shtetasit Kosovës dhe më gjerë. Megjithatë, për qdo ndërtim edhe më të vogël kërkohet një harmoni dhe balancim i shfrytëzimit të resurseve të natyrës ndaj mjedisit, me qëllim të shfrytëzimit të planifikuar dhe racional të tij. Gjatë aktiviteteve të tilla industriale, gjithnjë duhet pasur kujdes për ruajtjen e mjedisit jetësorë edhe për gjeneratat e ardhshme.

1.2. HISTORIKU I SHKURTËR I KOMPANISË

Kompania „Frutex” sh.p.k. me adresë në Shirokë, zona industriale. p.n. Suharekë është kompani private tregtare në pronësi të z. Shaqir Palushi, njëherit edhe në cilësinë e drejtorit të përgjithshëm. Kompania „Frutex” sh.p.k., është themeluar në vitin 2006, me aktivitete kryesisht të prodhim të pijeve freskuese dhe të lëngjeve me bazë frutash dhe tregtimin e tyre. Tani kompania ka bërë zgjerimin e biznesit me ndërtimin e objekteve të reja dhe gjithashtu edhe zhvillimin e aktiviteteve të reja në fshatin Novakë, komuna e Prizrenit, në parcelën e paraqitur si më poshtë, në parcellat me numër kadastral P-71813061-00695-1, P-71813061-00693-0, P-71813061-00692-0 me sipërfaqe totale S=14310m².

Ndërmarrja në fjalë është e pajisur me të gjitha dokumentacionet e lëshuara nga organet kompetente të qeverisjes lokale për ta ushtruar veprimtarinë (kjo dëshmohet edhe me

dokumentacionin e bashkangjitur këtij raporti). Prodhimin e pijeve freskuese dhe të lëngjeve me bazë frutash dhe tregtimin e tyre.

2.0. BAZA LIGJORE E PËRPILIMIT TË RAPORTIT TË VNM-së

2.1 Rregullativa ligjore

a) Dokumentacioni normativ

Legjislacioni në lidhje me ruajtjen e mjedisit është në përputhje me normativat evropiane të mbrojtjes së tij, ndonëse cilësia mjedisore është ende në parametra mjaft të ulët. Ligji i parë për mbrojtjen mjedisore në Kosovë daton në vitin 2003 dhe shprehet se të gjitha veprimtaritë e personave fizike dhe juridik, vendas apo të huaj, që ushtrojnë veprimtari të reja, do të jenë subjekt i vlerësimit të ndikimit në mjedis.

Në lidhje me vlerësimin e ndikimit në mjedis – VNM është aprovuar Ligji për VNM (Nr. 03/L-214) i cili përcakton të gjitha procedurat për përgatitjen dhe paraqitjen për miratim të VNM. Ligji për VNM (Nr. 03/L-214) ka për qëllim të sigurojë mundësimin e një vlerësimi të përgjithshëm me ndërthurje të ndikimeve mjedisore të projekteve apo veprimtarive që do të realizohen me qëllim që të parandalojnë dhe të zvogëlojnë apo mënjanojnë efektet negative në mjedis në kohën e duhur.

Ligjet dhe aktet nënligjore më të rëndësishme të aplikuara për hartimin e këtij raporti për projektin-biznesin i cili si veprimtari primare prodhimin e pijeve freskuese dhe të lëngjeve me bazë frutash dhe tregtimin e tyre janë:

- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025
- Ligji për VNM Nr. 03/L-214
- Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 04/L-060 për mbeturina Nr.08/L-071
- Ligji për planifikim hapësinor Nr. 04/L-174
- Ligji për ndërtim Nr. 04/L-110
- Ligji për mbrojtjen e natyrës Nr. 03/L-233
- Ligji për ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147

- Ligji Nr. 03/L-120 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për rrugë Nr. 2003/11
- Ligji për Kimikate Nr. 04/L-197
- Ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja. Nr. 08/L- 025
- Ligji për mbrojtjen nga Zhurma Nr. 02/L-102
- Ligji për mbrojtjen nga zjarri Nr. 04/L-012
- Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2022 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujqor.
- Udhëzim administrativ (QRK)- Nr. 03/2021 për menaxhiin e mbeturinave të rrezikshme
- Udhëzim administrativ (QRK)-08/2017 Për menaxhimin e deponive të mbeturinave
- Udhëzim administrativ Nr. 13/ 2013 për kaalogun shtetëror të mbeturinave
- Udhëzim administrativ (QRK)Nr. 07/2021 Për rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e palevizshme të ndotjes

b) Dokumentacioni teknik

Gjatë hartimit të raportit për vlerësimin e ndikimit në mjedis, përpos eksperiencës profesionale në udhëheqjen e procesit teknologjik për prodhimin e pijeve freskuese dhe të lëngjeve me bazë frutash, si dhe konsultimeve që janë bërë me ekspertët që udhëheqin procesin teknologjik, janë shfrytëzuar:

- Projekti kryesor i ndërtimit të fabrikës
- Projekti kryesor teknologjik i fabrikës
- Projekti kryesor i maqineris së fabrikës
- Certifikata e biznesit me veprimtari
- Certifikatat mbi të drejtat e pronës së paluajtshme
- Kopjet e planit të ngastërave
- Planin e situacionit

Krahas parashikimeve themelore nga regullativat ligjore të cekura më lartë për nevoja të hartimit të raportit të VNM-së janë shfrytëzuar edhe regullativa tjera ligjore, duke përfshirë ligjet aplikative të cilat tani janë në fuqi. Duke marrë parasysh faktin se një pjesë e madhe e specifikave mjedisore nuk janë përfshirë në kuadër të rregullativës së sipërshënuar për nevojat e hartimit të këtij raporti është shfrytëzuar edhe rregullativa relevante ndërkombëtare si dhe direktivat përkatëse për mjedis siç është direktiva e VNM-së.

2.1 Metodologjia e punës

Metodologjia e punës me të cilat bëhet vlerësimi i ndikimit në mjedis për fabrikën për prodhimin e pijeve freskuese dhe të lëngjeve me bazë frutash bëhet në disa faza edhe atë:

a) Informatat themelore që nënkupton identifikimet si që janë :

- burimet themelore të ndikimeve në mjedis.
- popullata ekzistuese me karakteristikat demografike.
- karakteristikat e dheut, topografia dhe peizazhi në lokacionin ku është ndërtuar fabrika.
- klima e lokacionit me të dhënat meteorologjike.
- kualiteti i ajrit dhe ujit në lokacionin më të gjerë.
- bota bimore dhe shtazore në terrenin e analizuar.

b) Vlerësimi i ndikimeve sipas këtyre kualifikimeve

- madhësia dhe lloji i ndotjes
- karakteristikat dhe dominimi i materialit ndotës
- gjendja e mjedisit në terrenin e analizuar
- vlerësimi i shpërndarjes në hapësirë i materies ndotëse

c) Përcaktimi i masave mbrojtëse sipas rezultateve të arritura mbi vlerësimin e ndikimit në mjedis në lokacionin ku është ndërtuar fabrika për prodhimin e pijeve freskuese dhe të lëngjeve me bazë frutash. Pjesa më e rëndësishme e analizës së këtij

raporti i kushtohet kvantifikimit dhe vlerësimit të gjendjes ekzistuese. Hulumtimi karakterizohet me faktin se kemi të bëjmë me vendin që ka të bëjë me potencial të shprehur ekologjik. Rezultati i këtyre analizave paraqet një dëshmi mbi gjendjen aktuale të mjedisit në këtë lokacion.

3.0. Përshkrimi i Lokacionit dhe Mjedisit.

Karakteristikat themelore të gjendjes ekzistuese të lokacionit janë bazë themelore për hartimin e raportit të VNM-së. Hulumtimi dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese është bërë duke i shfrytëzuar hulumtimet studimore të bëra në këtë teren si dhe komunikimit të drejtpërdrejtë me ponarin e kompanisë. Për të u definuar gjendja ekzistuese në mënyrë të kënaqshme dhe për të u krijuar një bazë reale për hulumtim të ndikimeve të mundshme, në kuadër të gjendjes ekzistuese janë prezantuar edhe të dhënat relevante që kanë të bëjnë me të dhënat ekzistuese morfologjike, gjeologjike, hidrologjike, hidrografike dhe meteorologjike.

3.1. Potencialet ekzistuese

Njëri nga elementet kyçë të hulumtimi i gjendjes ekzistuese të mjedisit është hulumtimi i potencialit ekzistues, e që konsiston në analizën e mirëfilltë të tërësisë hapësinore në zonën më të gjerë të lokacionit ku është ndërtuar kompleksi i fabrikës për prodhimin e pijeve freskuese dhe të lëngjeve me bazë frutash, me qëllim që në bazë të pasojave të njohura të vlerësohen mundësit e rrezikut ekologjik dhe në bazë të tyre të rekomandohen masat për zvogëlimin ose edhe eliminimin e tyre.

Karakteristikat e potencialit ekologjik përbëhen nga kombinimi i ndikimeve të ndërsjella të faktorëve natyror si që janë toka, uji, ajri, reliefi, flora dhe fauna.




Fig. 1. Raportet themelore ndërmjet faktorëve natyrorë dhe potencialeve ekologjike.

Çdonjëri nga potencialet ekologjike në këtë mënyrë posedon funksione të caktuara, që në esencë kanë rëndësi të dorës së parë analizën e problematikës së tërësishme të mbrojtjes së mjedisit, ndikimi i ndërsjellë i faktorëve të veçantë si dhe ndikimi i tyre në formimin e potencialit ekologjik dhe i funksioneve të tyre themelore me interes për analizën në fjalë, së bashku me kompleksin e marrëdhënieve të mundshme është paraqitur në figurën 1.

Në bazë të raporteve të paraqitura në fig. 1 është e qartë që faktorët natyror formojnë disa potenciale natyrore karakteristikat funksionale të të cilave duhen marrë parasysh gjatë valorizimit të ndikimit të Fabrikës të për fabrikën për prodhimin e pijeve freskuese dhe të lëngjeve me bazë frutash të ndërtuar në hapësirën konkrete.

3.2. PËRSHKRIMI I LOKACIONIT DHE MJEDISIT

Lokacioni ku është ndërtuar Kompleksi i fabrikës “Frutex” sh.p.k, me aktivitet prodhimin e pijeve freskuese dhe të lëngjeve me bazë frutash, ndodhet në ngastërat kadastrale nr. P-71813061-00695-1, P-71813061-00693-0 dhe P-71813061-00692-0 me sipërfaqe totale $S=14310m^2$ në vendin e quajtur “Crinqi-Deboz” në zonën kadastrale Novak të komunës së Prizrenit, gjithënjë sipas fletave poseduese nr. të lëndës 07-029-13981-22-Ç, 07-029-12024-22-Ç, përkatësisht 07-029-14236-22-Ç të gjitha këto prona private në emrin e pronarit të kompanis “Frutex” sh.p.k zotëri Shaqir Palushi.

Lokacioni ku ndodhet kompleksi i fabrikës është në pjesën periferike/veriore të komunës së Prizrenit, përkatësisht në kufrinin/vijën ndarëse ndërmjet regjionit të Prizrenit dhe Suharekës. Fabrika për prodhimin të pijeve freskuese dhe të lëngjeve me bazë frutash ndodhet në anën e djathtë të rrugës magjistrale Suharekë – Prizren, në kilometrin e 5, ndërsa fabrika është e projektuar në atë formë që ka qasje të lehtë dhe të përshtatshme për automjetet transportuese. Vendi ku ndodhet fabrika, ka një territor të përshtatshëm për këtë lloj veprimtarie, zona ka një terren të rrafshët, ndërsa organizimi i objekteve të fabrikës është bërë në atë menyrë që të ketë një qasje të lehtë dhe të përshtatshëm për puntorët dhe mjetet e transportit. Në afërsi të lokacionit ku është e ndërtuar kompleksi i fabrikës për prodhimin të pijeve freskuese dhe të lëngjeve me bazë frutash „FRUTEX” – Sh.p.k, me objektet e saj përcjellëse, në mënyrë të drejtpërdrejtë atakohen objekte të banimit (shtëpi banimi) të pronarit dhe vëllezërve të tij. Objektet e banimit gjenden në largësi mbi 40 metra nga parcellat në fjalë ndërsa me objektet e fabrikës kanë një distancë më të largët. Ndërsa objektet industriale gjenden larg nga fabrika sepse kjo zonë nuk përfshihet në planin zhvillimor të komunës së Prizrenit. Parcela nga tre anët (lindore-jugore dhe përendimore) është e rrethuar me parcela të pandërtuara kryesisht kullosa livadhe, ndërsa më larg nga këto parcel ka ndërtime të bizneseve të vogla të cilat janë të ndërtuar kryesisht për afarizëm. Këto vlerësime shërbejnë si bazë për kuantifikimin e ndikimeve të mundshme dhe për përcaktimin e masave të nevojshme mbrojtëse duke marrë parasysh se kemi të bëjmë me një projekt që mund të ketë ndikime të theksuara në mjedis. Fabrika për prodhimin

të pijeve freskuese dhe të lëngjeve me bazë frutash „FRUTEX” – Sh.p.k, në pikëpamje mjedisore, nuk do të ketë ndonjë ndikim relevant në popullatë, përpos që do të kenë vetëm dobi sepse një numër i popullatës janë punësuar në këtë Fabrika për prodhimin të pijeve freskuese dhe të lëngjeve me bazë frutash „FRUTEX” – Sh.p.k, si dhe marrja e shërbimeve dhe produkteve cilësore bëhet me e lehtë.

Pamja e lokacionit për ndërtimin e impiantit, për të pasur më të qartë është e përcjell me foton në vazhdim. **Pozita Gjeografike e lokacionit të kompleksit të fabrikës Frutex shpk në fshatin Novak komuna e Prizrenit.**




Fig. 3. Pamje satelitore nga lokacioni të fabrikës “Frutex” shpk



Fig. Pamaja e Objektivit të Fabrikës së prodhimit të lëngjeve.

3.3. Popullata dhe Vendbanimet

Vendndodhja e fabrikës në fjalë ndodhet në fshatin Novak, në anën e djathtë të rrugës e cila lidh komunën e Suharekës me atë të Prizrenit. Afër fshatit Novak ku edhe gjindet fabrika “Frutex” sh.p.k. ndodhet edhe fshati Gelnace dhe fashti Gjinoc fshatra nga komuna e Suharekës. Ky projekt do të jetë lehtësim për popullatën e komunes së Prizrenit dhe Suharekes por edhe të zonës përreth për shkak te afërsisë dhe lehtësimeve në transport, për furnizim më të afërt me produkte të kesaj veprimtarie si dhe mundësi punsimi për një numër të caktuar të popullatës vendase. Në lokalitetin përreth në një distance pak me të hasëm poashtu edhe në një veprimtari tjera, e cila si

aktivitet kishte prodhimin të Betonit, fabrik të stiroporit, restorante, etj, të cilat ndodhen në fshatrat Gelance dhe Gjinoc, afër rrugës magjistrale Suharekë-Prizren. Por që nuk kanë asnjë penges dhe ndikim të dëmshëm në zhvillim të biznesit në fjalë.

Sipërfaqja e përgjithshme e tre parcelave që janë në dispozicion për shfrytëzim në lokalitetit është **S=14310m²** kryesisht është zonë e rrafshtë dhe me infrastruktur mirë të rregulluar. E gjitha zona përreth është e karakterit fushor me bimë karakteristike për atë zonë dhe më shtepi banimi. Vendi se ku ndodhet impianti është paraqitur më mirë dhe më qartë në foton më lartë, marrë nga pamja satelitore, por ky raport do të jetë i shoqëruar edhe pamje tjera të fabrikës nga vlerësimi i zonës në fjalë.

Shtëpitë e zonës së banuar, janë në afërsi të drejtëpërdrejtë edhe pse ndërtimi dhe teknologjia në fabrikë, bëjnë që ndikimi të jetë shumë i vogël për ato, kur është në çështje mjedisi natyror. Infrastruktura është e rregulluar dhe shumë e përshtatshme, por sipas nevojës duhet marrë iniciativë nga vetë pronari për rregullimin e infrastrukturës, për minimizimin e ndotjes së mjedisit natyror dhe për interesat e punës së këtij impianti.

Pozita dhe ndërtimi i fabrikës, kanë rol të rëndësishëm, sepse çfarëdo ndikimi i mundshëm, nga ana e pronarit është marrë që të ketë ndikim minimal në mjedisin përreth.

Rruga është e rregulluar dhe e asfaltuar me të gjitha nivelet dhe standardet dhe të gjitha këto rrugë kanë qasje dhe kyqje të drejtëpërdrejtë në rrugën kryesore që lidhë me magjistralen Suharek – Prizren, po ashtu nga pjesa veriore kjo rrugë lidhet me rrugën kryesore Suharek - Malishevë - Prishtinë, për një furnizim të rregullt të banorëve të qytetit dhe ndërmarrjeve të afërta të lokalitetit. Ndërsa në një distanc jo shumë të largët kalon edhe autostrada Ibrahim Rugova.

Në zonën e gjërë dhe në zonen në fjalë, dominojnë kryesisht bashkësitë e larta bimore pyjore, zonë e karakterizuar me një begati pyjore ndërsa në afërsi të drejtëpërdrejtë dominojnë bim të ulëta.

Njërin nga veçoritë qenësore të hapësirës së analizuar, në kuptim të përcaktimit të ndikimeve të mundshme në mjedis, e paraqet popullata dhe demografia e saj. Këto

fakte kuptimin e plotë të tyre e kanë në hulumtimin e hollësishëm të ndikimeve të mundshme negative në banorët që jetojnë në hapësirën e analizuar. Meqenëse lokacioni i fabrikës është në kufirin ndarës Suharekë-Prizren, atëherë tek përshkrimi kemi të bëjmë edhe me komunën e Suharekes e cila në bazë të sasisë së ujit është një ndër vendet më pak të pasura me ujë. Kjo pozitë krijon parakushtet të vogla për zhvillimin e kulturave bujqësore, blegtorisë, industrisë ushqimore dhe të turizmit. Ndërsa shumë pran fabrikë kalon lumi Toplluga.

Kushtet hidrologjike dhe kushtet natyrore të komunës së Suharekes dhe Prizrenit ndikojnë në zhvillimin e bujqësisë dhe për zhvillimin e aktiviteteve turistike dhe rekreative.

E gjithë kjo zonë industriale ka ndikim në strukturën ekonomike prandaj bujqësia dhe turizmi merret si pjesë madhore e aktiviteteve ekonomike në komunën e Prizrenit - Suharekes dhe me gjërë. Siç e potencuam edhe më parë, përmes anës së Suharekës dhe në afërsi të lokacionit të fabrikës në distancë rreth 1 km kalon edhe autostrada „Ibrahim Rugova” e cila bashkon pjesën qendrore të gadishullit Ballkanik me detin Adriatik. Kjo rrugë, për arsye politike nga e kaluara sot nuk ka rëndësi aq të madhe, është një rast i mire që me valorizimin e saj të shfrytëzohen të gjitha përparsit e saj, duke mare parasysh që në të ardhmen dotë ketë ndikim primar në zhvillimin e vendit.

3.4. Lidhjet e Komunikacionit

Lokacioni ka lidhje mjaft të mira komunikacioni afër Fabrikë për prodhim të pijeve freskuese dhe të lëngjeve me bazë frutash, vendndodhja e fabrikës në fjalë konkretisht gjindet në zonën kadastrale Novak të komunës së Prizrenit dhe nga pjesa lindore dhe nga ajo veriore është e rrethur më fshtrat nga komuna e Suharekës. Ky projekt do të jetë lehtësim për popullatën e Suharekës por edhe të zonës përreth për shkak të afërsisë dhe lehtësimeve në transport, për furnizim më të afërt me produkte të kesaj veprimtarie.

Rruga e cila lidhë këtë fabrikë me pjesët tjera janë të asfaltuara dhe të rregulluara me standarde evropiane dhe lidhen me rrugën kryesore „Ukë Bytyqi” magjistranja Suharek - Prizren, e cila në Suharekë ka kyçe në Autostradën Ibrahim Rugova Prizren – Suharek – Prishtinë, lidhë lokacionin e fabrikës me të gjithë rrjetin rrugor të Kosovës, furnizimi me energji elektrike bëhet përmes rrjetit elektrik dhe trafos private, që e ka ndërtuar pronari i kompanisë, infrastruktura e ujësjellësit dhe rrjeti i kanalizimit është e rregulluar.

4.0. PËRSHKRIMI I KUSHTEVE EKZISTUESE

4.1 Mjedi natyror

Hapësira përreth vendit ku ndodhet Fabrikë për prodhim të pijeve freskuese dhe të lëngjeve me bazë frutash, gjendet në zonën kadastrake Novak komuna e Prizrenit. Në këtë zonë, në afërsi është kryesisht është zonë e banimit dhe bota bimore është mirë e zhvillur, ndërsa në distance pak me të largët dominon kryesisht objektet industriale dhe bota bimore nuk është mirë të zhvilluar si dhe një vegjetacion të dobët barishtor. Habitati kryesisht karakterizohet me një laramani bimore, që krijon një pamje të bukur në kohën e vegjetacionit të kësaj zone. Gjatë punës së rregullt të fabrikës mundësit e ndotjes vijnë nga:

- Automjetet e caktuara që shpërbejnë për kryerjen e aktiviteteve në fabrikë,
- Emisionet e pluhurit nga ushtrimi i verpimtarisë punuese,
- Emisionet e pluhurit nga aktiviteti i procesit teknologjik.
- Emisionet nga gjeneratori,
- Larja e produkteve dhe paisjeve prodhuese, dhe sipërfaqeve manipuluese,
- Derdhja aksidentale e vajrave hidraulik dhe motorik, etj.

4.2. Potencialet ekzistuese

Njëri nga elementet kyçe të hulumtimi të gjendjes ekzistuese të mjedisit është hulumtimi i potencialit ekzistues, e që konsiston në analizën e mirëfilltë të tërësisë

hapësinore në zonën më të gjerë të lokacionit ku është ndërtuar Fabrikë për prodhim të pijeve freskuese dhe të lëngjeve me bazë frutash, me qëllim që në bazë të pasojave të njohura të vlerësohen mundësit e rrezikut ekologjik dhe në bazë të tyre të rekomandohen masat për zvogëlimin ose edhe eliminimin e tyre. Karakteristikat e potencialit ekologjik përbëhen nga kombinimi i ndikimeve të ndërsjella të faktorëve natyror si që janë toka, uji, ajri, reliefi, flora dhe fauna.

Çdonjëri nga potencialet ekologjike në këtë mënyrë posedon funksione të caktuara, që në esencë kanë rëndësi të dorës së parë analizën e problematikës së tërësishme të mbrojtjes së mjedisit.

Atmosfera është një sistem dinamik i cili vazhdimisht ndodhet në interaksion me komponentët e ndryshme të ndotjes. Si rezultat i interaksioneve mes komponenteve të ndryshëm mjedisor paraqitet ndotja sekondare, të cilat shprehen me ndryshimin e karakteristikave fizike të temperaturës, regjimit të dritës, sasisë së të reshurave dhe parametrave tjerë në plan lokal, ose ndryshime të mundshme edhe në planin global, por edhe potencimi më i madh i dëmit të të njëjtit përqëndrim të ndotjes, varësisht prej rrethanave të motit (psh: dukuria e inversionit të temperaturës).

Vendi ku zhvillohet aktiviteti, është rajon i përshkruar me klimë të mesme kontinentale, me dimër relativisht të ftohtë, si dhe verë të nxehtë.

4.3. Relievi

Vendi ku ndodhet Fabrikë për prodhim të pijeve freskuese dhe të lëngjeve me bazë frutash, karakterizohet me një relief kryesisht të rrafshet, me ultësirat e livadheve dhe në distanca pak me ta largëta edhe kodra.

Karakteristikat e peizazhit të tërësisë së analizuar hapësinore paraqesin njërin nga elementet për të perceptuar marrëdhëniet e tërësishme në relacionin fabrikë – mjedis. Me këtë rast gjithsesi duhet marrë parasysh se bëhet fjalë për një kategori psikologjike afektive e cila manifestohet përmes veprimit të tërësishëm sinergjik të rrethinës në shikuesin, ku medoemos janë të pranishme implikimet kulturologjike, sociologjike dhe subjektive. Efektet vizuale (peizazhet) janë kriteriume me rëndësi në ruajtjen e mjedisit dhe nëse nuk zgjidhen drejt konsiderohen si degradim i mjedisit. Andaj pritet nga kompania që të punoj në

harmoni me natyrën dhe të mos ndikoj në aspect negative në pamjen vizuale të zonës ku bëhet zhvillimi i aktivitete të fabrikës “Frutex” shpk.

4.4. Toka

Në aspektin pedologjik, toka ku ndodhet Fabrikë për prodhim të pijeve freskuese dhe të lëngjeve me bazë frutash, të ndryshme, bashkë me elementet tjera përcjellëse, bënë pjesë në tokat mesatarisht të zhvilluara, me një shtresë të humusit mesatarë. Kjo sipërfaqe e tokës është e përshtatshme për aktivitetin që po zhvillohet, pavarësisht që toka ka pësuar dëme gjatë largimit të bimësisë që kanë qenë aty.

Natyra dhe biodiversiteti

Në bazë të dhënave zyrtare të Institutit për mbrojtjen e Natyrës, nuk ekzistojnë të dhëna se në këtë lokalitet kemi të bëjmë me ndonjë hapësirë të mbrojtur me ligj, në drejtim të biodiversitetit dhe natyrës në përgjithësi, por as që është ndonjë zonë/territor që është potencial të futet nën mbrojtje.

4.5 Flora

Në bazë të shqyrtimeve vizuale të zonës ku zhvillohet veprimtaria, para zëvillimit të aktivitetit kemi hasur kryesisht në bimë të larta, me kurorë të zhvilluar (Querqus, Fraxinus etj), shkurre e gjysëmshkurre si dhe forma barishtore. Flora e kësaj zone, shtrihet në një lartësi mbidetare të konsideruar. Në këtë zonë, janë prezent edhe bimët të tjera, që u përshtaten kushteve të rajonit. Për momentin në lokacionin ku është duke operuar fabrika “Frutex” janë hequr të gjitha pjesët barishtore dhe mbulesore të tokës dhe është objekte afariste dhe asfalt.

4.6. Fauna

Fauna ekzistuese dhe kushtet klimatike të kësaj ane, duke marrë për bazë edhe të dhënat nga vendasit, në këtë zonë jetojnë:

- Gjitarët: Lepuri i egër, Dhelpira
- Zvarranikët: Gjarpri, Hardhuca, Breshka e tokës, etj.
- Brejtësit janë evidentuar: Minjtë, etj.

- Nga insektet krahë fortë, krahë lusporë, janë evidentuar lloje te ndryshme te fluturave, Bletës mjaltë dhënëse, llojeve te ndryshme te thneglës, Mizat, mushkonjat, etj.
- Ndërsa prej shpezëve janë karakteristike: Bilbilat, Laraskat, Pëllumbi, etj.

4.7 Ndikimi në ujërat

Ndotja e ujit nënkupton të gjitha ndryshimet kualitative apo kuantitative të përbërjes dhe cilësisë natyrore kimike, fizike dhe biologjike, të cilat mund të shfaqin pasoja të padëshirueshme për shëndetin e njeriut, ekonominë dhe ekosistemin në përgjithësi.

Natyra dhe llojet që atakojnë ujërat janë të ndryshme, nga burime të ndryshme. Duke marrë parasysh prejardhjen e tyre, në përgjithësi, ndotjet mund të karakterizohen si: urbane, industriale, bujqësore, etj. Kuptohet se sipas kualitetit dhe karakteristikave të tyre, ujërat efluente urbane dhe ato industriale dallohen në mes vete dukshëm. Është e qartë se tipet e ndryshme të ndotësve zakonisht kanë efekte të ndryshme biologjike.

Në lokacionin ku ndodhet Fabrika “Frutex” shpk në zonën kadastrale Novak, shumë afër kalon edhe lumi Toplluga, dhe për momentin ujërat e fabrikës shkarkohen në atë lumë, por që sipas investitorit shume shpejt do të ndërtohet edhe impianti për trajtimin e ujërave. Kompania Frutex shpk, për nevojat veta i shfrytëzon ujërat nëntokësore të nxjerrë përmes pusave që ka hapur kompania. Këto ujëra, pas përdorimit në proces teknologjik, duhet ti nënshtrohen procesit të trajtimit kimik dhe biologjik dhe pastaj të derdhen në recipient, kanalizim të qytetit.

Impianti i lartë përmendur, i cili do të ndërtohet për trajtim të ujërave, do të jetë i pajisur me basene prej betoni, të pajisur me filtra dhe separator të mbuluar dhe pastaj derdhet në kanalizim.

Nuk ka elemente të pluhurit, që do të shkaktohej gjatë lëvizjes së makinave, gjatë furnizimit me lëndë të parë pranë këtij impianti. Por, as ujëmbledhësit që mund të krijohen nga të reshurat, nuk do të ndikohen nga ky aktivitet, pasi që do të jetë i rregulluar, mekanizmi i grumbullimit të ujërave atmosferike dhe atyre nga procesi i prodhimit dhe mirmbajtjes.

4.8 Ujërat sipërfaqësore

Kosova karakterizohet me një rrjet të zhvilluar hidrografie. Ujërat e pellgut të Drinit të Bardhë, rrjedhin në drejtim të Detit Adriatik. Përpunimi themelor i shënimeve hidrologjike dhe kompletimi i tyre, tregon se diapazoni i rrjedhjeve në baze të matjeve, kryesisht është në të gjitha profilet, dukshëm më i vogël nga amplituda e ndryshimit të rrjedhës, përkatësisht niveli i ujit është 10 % për Lumëbardhin e Prizrenit, në Vermicë. Në kuadër të analizës së regjimit të ujërave sipërfaqësore është bërë përpunimi i ujërave rrjedhave me karakteristike.

Këto ujëra, nuk do të ndikohen nga aktiviteti i punës, pasi që nga pronari i Fabrikë për prodhim të pijeve freskuese dhe të lëngjeve me bazë frutash, do të jetë i rregulluar me kanalizim dhe infrastrukturë percjellese. Kjo na lejon të kuptojmë se ndikimi në ndotje të ujërave sipërfaqësore, do të jetë i pa përfillshim. Nuk ka elemente të pluhurit, që do të shkaktojnë gjatë lëvizjes së makinave, gjatë furnizimit me karburant pranë këtij impianti. Por, as ujëmbledhësit që mund të krijohen nga të reshurat, nuk do të ndikohen nga ky aktivitet, pasi që do të jetë i rregulluar, mekanizmi i grumbullimit të ujërave atmosferike.

Megjithatë, mendohet se nuk do të ketë ndotje eventuale, prapë se prapë ndotja në ujëra duhet të jetë në kontroll të ekipit special, që të mos vije deri te ndonjë eksces ekologjik. Ujërat mund të ndotën, vetëm në rast të katastrofës ekologjike apo ndonjë incidenti (avarie), përndryshe, i tërë procesi i punës do të jetë nën kontrollin e udhëheqësve të punës.

4.9. Ujërat Nëntokësore

Analiza e ujërave nëntokësore në territorin e Republikës së Kosovës, i kanë parapri shënimet e shumta gjeologjike dhe gjeo - tektonike të karakteristikave të territorit. Rrafshi aluvial i Drinit të Bardhë dhe i degëve të tij në këtë rast Toplluga arrijnë gjatësinë më 2.5 km, me trashësi të aluvionit prej disa dhjetëra të metrash, e që është hulumtuar në mënyrë të pafundshme dhe jo të barabartë. Trashësia e vrushkujve në kuadër të këtyre shtresave është 3 - 8 m. Produktiviteti i puseve në kuadër të këtyre shtresave ndryshon prej 3-10 l/sec. Regjimi i vrushkujve në aluvionin e Drinit të

Bardhe, atje ku është vrojtuar, dëshmon se niveli maksimal i ujerave nëntokësore paraqitet në periudhën mars-maj, dhe niveli minimal në periudhën gusht-tetor. Amplituda e nivelit të ujit oscilon nga 0.30 – 4.32 m, ndërkaq mesatarja vjetore e nivelit oscilon 0.30 – 0.60 m, nga mesatarja shumëvjeçare. Vrushkujt karnik paraqiten në masivet gëlqerore përgjatë basenit Dukagjin-Prizren, e që në pikëpamje hidrologjike është burim mjaft i rëndësishëm e me sasi të mëdha të ujit të akumuluar.

Sa i përket tipit të ujërave të lartë shënuar, ato janë të shumta në këtë regjion dhe në këtë lokalitet, sepse edhe gjatë fazës punuese janë lajmëruar këto ujera me një sasi të rrjedhës mbi sipërfaqe prej 3–4 litra, për sekondë, e që janë planifikuar dhe po ashtu konstruktuar me kaptazhë për shfrytëzim për nevojat e këtij impianti.

Kompania “FRUTEX” SHPK, ujin për shfrytëzim e merr nga ujërat nëntokësor, i cili uji me pompa nxjerret nga pusi dhe shfrytëzohet për nevojat e fabrikës.

Parametrat kryesor të shfrytëzimit të ujit rezultojnë të jenë:

1. Niveli pjezometrik i burimit 0.5 m mbi sipërfaqen e tokës
2. Prurja e ujit 4 liter/s
3. Shfrytëzimi i ujit nga kompani është 1.3 l/s
- 4. Niveli i uljes së pompës 100 m**

Objekti	Pëshkrimi	Karakteristikat kryesore
Burimi i Furtexit	Thellësia	150 m
	Diametri	24-150 m
	Diametri i gypave / filterit	D = 166 mm
	Matreali i gypave / filterit	Qelik i galvanizuar
	Mediumi filtrues	Rërë kuarcorë: 4-8mm

4.10. Peizazhi

Pamja e këtij regjioni është karakteristike, shumë e bukur e kombinuar, e përbërë nga pjerrtësira të pasura me ndertime të kompleksit të fabrikës ku sipas planit është bërë edhe mbjellja e bimëve të larta dekorative të llojit pyjor, dhe një pamje imponuese që i jep pozita gjeografike të lokaconit ku është ndërtuar Fabrikë për prodhim të pijeve freskuese dhe të lëngjeve me bazë frutash.

Gjatë fazës së ndërtimit sikur që u cek më lartë është dashur të hapet një pjesë e bimesise për të krijuar sipërfaqen e nevojshme për objektin dhe infrastrukturën përcjellëse, por parashihet që peizazhi nuk do të pësoi ndryshime të mëtutjeshme dhe degradim, dhe si i tillë nuk ka nevojë të parashihet masa shtesë, të cilat do të duhej të merren. Operatori është i obliguar, që të mendoj dhe të kontribuoj në kultivimin e bimësisë në oborrin e Ndërmarrjes, në mënyrë që të minimizoj humbjet në aspektin floristik që janë bërë, poashtu që të siguroj një mjedis të këndshëm edhe për stafin e Ndërmarrjes. Në momentin e perpilimit të raportit të VNM-së objektet ka qenë të perfunduar me të gjitha funksionet dhe infrastruktur moderne.

4.11. Dukshmëria

Shikuar nga relievi, ku është ndërtuar objekti i Fabrikës dhe objektet e sajë përcjellëse, dukshmëria është e lartë dhe deri diku atraktive, mund të mbërrijë gjerë në disa kilometra. Këtë rajon, disa herë e shohim të mbuluar nga mjegulla e hershme pranverore, apo ajo vjeshtore, sidomos në orët e hershme të mëngjesit.

4.12. Erërat

Në lokacionin e fabrikës Frutex shpk në zonën kadastrale Novak, më së shumti janë të përfaqësuar erërat veriore. Me intensitet më të madhe të shpejtësisë paraqiten erërat veriore, veri perëndimore si dhe erërat perëndimore, kurse ato jugore janë me intensitet më të vogël. Në rrethinë në përgjithësi erërat më të shpeshta janë ato veriore me 26 % dhe më të rrallat janë ato jug – perëndimore me 27%, kurse shpejtësia mesatare më e madhe e erës është 3.2 m/sek.




Figure 5. Trendafili i erërave

4.13. Reshjet

Tek pasqyra e reshjeve, në studimet ekzistuese është shikuar perioda 1948-1986. Reshjet janë element apo faktorë shumë i rëndësishëm për zhvillimin e hidroekonomisë, duke përfshirë debitin e ujërave nëntokësor. Në këtë studim do ti paraqesim reshjet për stacionin Prishtinë dhe Prizrenit. Në tabelën e më poshtë janë të dhëna e reshjeve mesatare mujore dhe vjetore.

Muajt	Reshjet Mesatare mm	Sasia absolute maksimale mm	Sasia absolute minimale mm	Maksimumi absolut ditor
I	50.4	103.1	3	38.7
II	47.6	83.6	14.6	25.9
III	46.5	134.6		31.2
IV	53	97.3		50
V	81.3	170	26.2	92.4
VI	58.3	107.7	18	42.5
VII	51.5	105.2	0.2	49.4
VIII	48.2	145.7	5	52.4
IX	41.7	117.2	10.8	46.7
X	68.3	133.5	0.3	48
XI	72.6	133.5	15.2	60.1
XII	53.9	162.4	12.9	36
Vjetore	673.3	911	466.4	92.4
Dimri	151.9			
Pranvera	180.8			
Vera	158			
Vjeshta	182.6			
Për. Vegje	334			




Fig. 4 Paraqitja grafike mesatare e reshjeve nga tabela e sipërme

4.14. Kushtet klimatike

Lokacioni i I fabrikës Frutex shpk në fshatin Novakë, ka klimë të lagësht kontinentale me ndikim mesdhetar dhe oqeanik, që karakterizohet me vera të nxehta dhe dimra të ftohtë me borë. Temperatura mesatare vjetore në Kosovë është 9.5 °C. Muaji më i nxehtë është Korriku me një temperature mesatare prej 19.2 °C. Rrafshi i Kosovës ndikohet nga masat ajrore kontinentale dhe për këtë arsye dimrat janë të ftohtë me temperatura mesatare të ajrit mbi -10 °C. Gjatë stinës së Verës bën temperaturave mesatare prej 20 °C dhe nganjëherë temperaturat arrijnë deri në 37 °C. Kjo zone në përgjithësi karakterizohet me klimë të thatë dhe me reshje totale vjetore prej 600- 700 mm në vit.

Zona e studimit shtrihet në pjesën jugore të Kosovës që ndikohet më shumë nga regjimi kontinental i reshjeve, i cili është i njohur për mungesë reshjesh gjatë vitit. Sasia më e lartë e reshjeve të shiut është në Maj, ndërsa sasia më e ulët gjatë dimrit. Përveç, kësaj, reshjet e borës janë një ngjarje e zakonshme në Kosovë me 25 deri 100 ditë me reshje bore në vit. Stacioni më i afërt meteorologjik që ka publikuar të dhënat është Stacioni i Prizrenit, duke iu referuar të dhënave nga periudha 2000 – 2012.

Climate data for Drenas													[hide]
Month	Jan	Feb	Mar	Apr	May	Jun	Jul	Aug	Sep	Oct	Nov	Dec	Year
Average high °C (°F)	4.1 (39.4)	6.1 (43.0)	10.6 (51.1)	15.5 (59.9)	20.2 (68.4)	24.8 (76.6)	27.6 (81.7)	28.2 (82.8)	22.3 (72.1)	16.8 (62.2)	11 (52)	5.2 (41.4)	16.0 (60.9)
Average low °C (°F)	-3.4 (25.9)	-2.3 (27.9)	0.8 (33.4)	5 (41)	9.9 (49.8)	14.1 (57.4)	16.4 (61.5)	16.2 (61.2)	11.9 (53.4)	7 (45)	2.3 (36.1)	-1.8 (28.8)	6.3 (43.4)


Source: Climate-Data^[6]

Fig 3. Të dhënat për kushtet klimatike


5.0. PROCESI TEKNOLOGJIK PËR PRODHIM TË PIJEVE FRESKUESE DHE TË LËNGJEVE ME BAZË FRUTASH.

Procesi i teknologjik i fabrikës “Frutex” SH.P.K. në zonën kadastrale Novak komuna e Prizrenit e cila në bazë të qertifikatës së biznesit merret me ushtrimin e një serë aktiviteteve ndërsa në lokacionin në fjalë si aktivitete kryesore ka prodhimin e pijeve freskuese dhe të lëngjeve me bazë frutash. Pra në këtë fabrikë bëhet prodhimin i lëngjeve me bazë të frytave dhe pijeve freskuese (pijeve energjike), në disa linja të prodhimit si: linja e qelqit, plastikës dhe linja e kanaqeve.

Skema e procesit teknologjik (Përzirja e shurupit)



Skema e procesit teknologjik të mbushjës (linja e qelqit)



5.2. Procesi teknologjik i përgatitjes së lëngjeve dhe pijeve freskuese

Fabrika për prodhim të pijeve freskuese dhe të lëngjeve me bazë frutash në linjat e saj të prodhimit, frutat i merrë nga plantacionet e mbjela nga vetë kompania si dhe nga prodhuesit tjetër vendor. Gjithashtu pjesa tjetër importohet nga jashtë, sipas kontratës të lidhur me fabrikat e prodhimit të puresë së frutave. Kerkesat për këtë lëndë të parë respektohen sipas standartit të BE për prodhimin e lëngjeve të frutave. Pureja e frutave vjen e kontrolluar dhe e shoqëruar me fletë analizën përkatëse të ngjitur në ambalazh.

5.2.1 Proceset që ndodhin para atij të lëngëzimit

Pureja e mollëve duhet të pastrohet nga copat e mëdha, sepse procesi i presimit vështirësohet. Nga tipi i paisjeve të ekstraktimit varet dhe efikasiteti i metodave.

Megjithëse molla përmban një sasi të madhe të enzimave që i japin mollës ngjyrën kafe, pektinat janë në përmbajtje të ulët. Kështu zakonisht shtohen enzima zbutëse. Ka një

numur enzymash të përgatitura posaçërisht për para-trajtimin e puresë së mollës, për të ulur viskozitetin e pulpës.

5.2.2 Procesi teknologjik i përgatitjes së lëngjeve përfshin një sërë veprimesh, të cilat janë:

- Ngrohja e pulpës
- Përftimi i lëngut
- De-ajrimi
- Kullimi
- Kthjellimi
- Ndreqja dhe normalizim
- Pastërizimi i mbushjes
- Ruajtja

Këto veprime kryhen në aparatura dhe makineri të ndryshme.

5.2.3 Ngrohja e pulpës - Pulpa e frutave dhe perimeve e cila përfitohet nga makina grirëse, shpesh para se të presohet, i nënështrohet ngrohjes në temperaturë 70-80 C. Ky veprim, meqënëse shkakton koagulimin e proteinave që gjenden në protoplazmën e qelizave si dhe hidrolizën e lëndëve pektike, lehtëson të liruarit të lëngut dhe rrit rendimentin e tij. Ngrohja e shpejtë e lëngut meqënëse asgjëson veprimtarinë e tharmëve oksiduese, sidomos të një tharmi të këtij grupi të quajtur polifenoloksidaze, ndikon jo vetëm në ruajtjen e vitaminës C, por pengon dhe nxirjen e lëngjeve.

Nxehja e shpejtë e lëngut të mollës në 82C dhe 85C do të koagulojë ato grimca që ndikojnë në filtrimin e lëngut. Lëngu më pas ftohet filtrohet dhe centrifugohet. Ka disa vështirësi me këtë metodë. Një hap shtesë me nxehje është prioritar për pasterizimin final dhe mund të jetë përcaktuese për aromatizimin e lëngut.

Ftohja e shpejtë është e nevojshme për të minimizuar ndryshimet e aromës. Në qoftë se temperatura e pasteizimit është më e lartë se ajo që përdoret për nxehjen e shpejtë, do të ndodhë një koagulum shtesë me shtimin e nxehtësisë pas mbushjes.

5.2.4 Përftimi i lëngut - Nga pulpat e frutave dhe të perimeve, lëngu nxiret zakonisht me procesin e shtrydhjes ose të presimit. Meqënëse përftimi i lëngut, si nga pikpamja sasiore ashtu dhe cilësore, varet nga një sërë faktorësh, vecoritë e ndërtimit të tulit të frutave dhe të perimeve, shkalla e pjekurisë, përberja kimike, etj, procesi i shtrydhjes së pulpave kryhet me presa të ndryshme, që dallohen jo vetëm nga ndërtimi, por sidomos nga mënyra, shpejtësia dhe cilësia e shtrydhjes.

Te presat shtresore pulpa vendoset në pëlhura të cilat pasi lidhen, vecohen nga njëra-tjetra me korniza katërkëndëshe prej druri ose prej metali, me përmasa nga 0.8-1m. Në presa të tilla, në të cilat rendimenti i lëngut të presuar është më i madh se në presat me kosh, mund të vendosen njëra mbi tjetrën për tu shtrydhur deri në 40 shtresa (peceta) me pulpe.

Nga këto dy lloje presash, trysnia shtrydhëse ushtrohet me përdredhjen e vidhës, veprim ky që mund të kryhet me dorë ose në mënyrë mekanike, nga lart-poshtë. Trysnia e ushtruar në presat mund të jetë edhe hidraulike, si te presat hidraulike. Procesi i presimit duhet të kryhet ngadalë, pasi shtrydhja e vrullshmë mund të grisë pëlhurën mbështjellëse të koshit ose “pecetat” dhe, si pasojë, bashkë me lëngun të dalin edhe mbeturinat e ngurta të tij. Pulpa presohet disa herë. Lëngu i presimit të parë është më i mirë nga pikpamja e përbërjes më të plotë të lëndëve ushqyese: ai përmban më shumë sheqër, vitamina, kripra minërale.

Nga presimi i tretë e lart, lëngu që përftohet është i cilësisë më të dobët, përmban më shumë lëndë taninë, më pak sheqerna, etj. sesa lëngu i presimit të parë dhe të dytë.

Presimi i disa lloj frutave dhe perimeve mund të kryhet dhe me presat në formë shneku (bosht në formë vidhe) i cili, duke u rrotulluar për së gjati brenda një korite metalike prej celiku inoksidabël, shkakton shtrydhjen. Presa të tilla mund të shërbejnë për shtrydhjen e domatëve, të portokalleve të qëruara, të frutave, si manat, luleshtrydhet, etj.

Rendimenti i lëngut që del nga presimi varet nga disa faktore:

- **Ndërtimi anatomik i indeve të tij**
- **shkalla e pjekurisë**
- **lloji i presës**
- **mënyra e presimit**

Rendimenti mesatar i lëngut nga presimi i disa lloje frutash paraqitet si më posht (nga 100kg)

- **Rrushi 70-83 kg**
- **Dardhët 63-85kg**
- **Mollët 63-80kg**
- **Luleshtrydhet 70-85kg**

Për rritjen e rendimentit të lëngut që mund të përfitohet nga pulpa e frutave të ndryshme, përdoren edhe preparatë që tretin lëndët pektinike, të ashtuquajtura tharmë pektolitike. Këto hidhen në pulpë disa orë para presimit në masën nga 0.2-0.4%

5.2.5 Centrifugimi i lëngut të mollës - Lëngu i centrifuguar është lehtësisht i qartë, por ende me mjegull dhe viskoz, krahasuar me lëngun e filtruar, sepse përmban akoma suspensione. Lëngu i presuar futet në një tub tubolar, ose vazhdon centrifugimin. Të dyja keto lloje duket se funksionojnë mirë, por lloji që vijon është vetëpastrues, prandaj ky veprim nuk ndalon për tu pastruar.

5.2.6 Deajrimi - Ky proces ka si qëllim të largojë ajrin nga masa e lëngjeve. Shumë lëngje frutash dhe përimesh, nga shkaku i tharmëve të grupit të oksidazave që përmbajnë, sidomos të njërit prej tyre, të polifenoloksidazës, i cili gjallërohet dhe bëhet veprues në prani të oksigjenit të ajrit, pësojnë ndryshimë të padëshirueshme, nxihen, humbasin një pjesë të vitaminës C (nga shkaku i veprimit të tharmit askorbatoksidazë) etj.

Meqënëse këto dukuri që i prishin cilësinë e lëngjeve, përfitohen nga prania e ajrit (oksigenit), për t'i parandaluar ato, praktikohet heqja e ajrit (deajrimi) nga masa e lëngjeve.

Nga mënyrat e ndryshme të deajrimit, më i thjeshtë është deajrimi zhytës, i cili zbatohet në mbajtjen e shisheve ose të kutive të lëngjeve të pavulosura (pa i mbyllur), të mbushura 0C,

me lëngje, të zhytura në ujë të ngrohtë në temperaturë 80-90 në tava të posacme, për periudha kohe të ndryshme. Gjatë kohës që zgjat mbajtja e enëve me lëngje të zhytura në ujë të ngrohtë, gazet që përmbajnë ato të tretura (ndër to dhe oksigjen) mënjnohen nga masa e lëngut.

5.2.7 Kullimi - Ka si qëllim të mënjanojë nga përmbajtja e lëngut pjesët e ngurta sifarat, copat e lëkurës, etj të cilat mund të kenë kaluar në lëng nga pakujdesia ose moszbatimi i rregullt i procesit teknologjik. Lëngjet kullohen nëpër sita prej celiku inoksi ose prej alumini ose nikeli.

5.2.8 Filtrimi - Filtrimi është i nevojshëm për të arritur një qartësi sa më të mirë të lëngut të mollës. Filtrimi i lëngut të freskët të presuar është një operacion i vështirë, përshkak të përmbajtjes së pektinave në lëng dhe për shkak të aftësisë së formimit të mjegullës në aparatit e filtrimit. Lëngu i patrajtuar mund të filtrohet me vështirësi në filrame kapacitet të madh dhe me zona filtrimi të mëdha. Lëngu ka aromë të mirë. Ai mund të ketë një mjegull të lehtë që shkaktohet nga prania e taninave dhe proteinave. Lëngu itrajtuar me metodën e filtrimit nga i cili nuk janë larguar peptinat mund të zvogëlojë shkallën e filtrimit me 30%, krahasuar me trajtimin me enzima të tij.

Ka shumë tipe filtrash me kapacitet të ndryshëm. Preferohen filtrat me aftësi zbrazëse në pjesën e pasme. Në para-filtrat e mbuluar, lëngu shtyhet nga presioni i vakumit drejt një membrane të mbuluar. Në rastin e lëngut të mollës, një mesatare është zakonisht e vlefshme në shumë shkallë. Duhet aftësi dhe eksperiencë për të vepruar me një filtër, në rastin e lëngut të mollës.


Filtri është një pajisje me teknologji të lartë . Ai është i ndërtuar prej dy lloje piastrash, filtruese dhe jo filtruese. Pjastrat janë material plastik. Ne pjesen e poshtme filtri është i pajisur me një kazan metalik prej inoksi për shkarkimin embetjeve.

5.2.9 Kthjellimi - Është veprim që nuk kryhet për të gjitha lëngjet. Ky proces zbatohet rrallë meqënëse, prej shumë vitesh në prodhimin industrial është bërë traditë përgatitja e lëngjeve në gjendje të turbullt, ashtu sikurse përftohen nga shtrydhja e fruta-përimeve. Ka mjaft raste, si për lëngjet e rrushit, të mollës dhe të disa frutave të tjera, që kthjellimi është i domosdoshëm. Turbullimin e lëngjeve e shkakton sidomos acidi pektinik, i cili është më pak i tretshëm, por edhe proteinat, amidoni, pentozat etj.

Në kushtet e prodhimit industrial praktikohen disa mënyra për kthjellimin e lëngjeve. Nga mënyrat e kthjellimit po përmëndim këto

5.2.10 Vetkthjellimi; i cili kryhet duke mbajtur lëngjet e frutave për njëfarë kohe (disa orë) në qetësi, në temperatura të ulëta. Në kushtë të tilla precipitojnë substancat që qëndrojnë pezull në masën e lëngut dhe shkaktojnë turbullira. Në këtë rast kthjellimi ndodh si rezultat i shpërbërjes që pësojnë molekulat e acidit pektinik, i cili me kalciumin edhe magnezin jep përbërje të patretshme, po kështu edhe nga veprimi i tharmit pektinazë, që çon në përfitim të acidit galakturonik, Acidi galakturonik ($C_6H_{10}O_7$) është përbërësi kryesor i pektinave. Përftohet nga hidroliza e pektinave. Tharmin e pektinazës e përmban vetë lëngu i frutave. Si pasojë e një veprimi të tillë, zvogëlohet veshullia e lëngut dhe krijohen kushte më të përshtatshme për vetkthjellimin.





6.0. IDENTIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NË MJEDIS

Raporti për vlerësimin e ndikimit në mjedis duhet të përmbajë në mënyrë të detajuar të dhëna relevante sa i përket faktorëve ndotës të ndryshëm teknologjik që rrjedhin nga puna e prodhimit të Fabrikës së përpunimit dhe prodhimit të pijeve freskuese dhe të

lëngjeve me bazë frutash e cila mund të ndikohet në kualitetin dhe kuantitetin e komponentëve të natyrës në përgjithësi. Të gjitha ndikimet e mundshme nuk janë të vlerave të njëjta, prandaj duhet të bëhet edhe kuantiteti i tyre.

Kompania “Frutex” shpk, me veprimtarine e prodhimit të pijeve freskuese dhe të lëngjeve me bazë frutash me teknologjine e saj merr në konsiderate të gjitha ndikimet që ka ky aktivitet në mjedis dhe me gjerë. Nuk shkakton demtime sidomos të ekosistemit përreth apo të ekosistemeve të tjera përreth zonës ku është ngritur objekti. Meqenëse në këtë objekt ka përfundim kimik dhe biologjik, rrjedhimisht ka edhe shkarkime të ujrave teknologjike në mjedise të hapura (lumë). Aktiviteti i impiantit për prodhim të pijeve freskuese dhe të lëngjeve me bazë frutash, mund të shkakton ndotje të ujrave sipërfaqësore, dhe të atyre nëntokesore, nese këto ujëra shkarkohen në mjedis të hapur pa ndonjë paratrajtim të veçantë në inpiante për trajtimin e ujit.

Instalimi i procesit teknologjik të prodhimit të pijeve ka furnizim të pandërprere me uje nga burimi vetiak i kompanisë, nga pusët që janë hapur në lokacionin e fabrikës. Ujrat teknologjike shkarkohen ne kanalin kullues te parceles, nëpermjet një linje të posaçme, sipas projektit te zbatuar, kurse ujrat e zeza shkarkohen ne gropen septike

6.1. Ndikimet në ajër

Në aktivitetin e prodhimit të prodhim të pijeve freskuese dhe të lëngjeve me bazë frutash, si dhe produkteve tjera nga akiviteti prodhues ndikime negative paraqiten në ambientin e ajrit dhe atë: Ajri mund të ndotet gjatë lirimimit të pluhurit i cili krijohet gjatë deponimit dhe zbrazjes së Pemëve dhe Perimeve, nga mundësia e lirimimit të pluhurit dhe gazit nga automjetet transportuese.

Veprimtaria e objektit nuk është burim i emetimeve ne ajer te gazeve qe mund te ndotin atmosferen, nuk ka erera te keqia shqetesuese per komunitetin per rreth e as per punonjesit.

Aktiviteti nuk ka ndikim mbi atmosferën, përberjen e saj dhe klimën. Si rrjedhim nuk ndikon në shëndetin e njerezve, të flores dhe faunes përreth. Gjatë veprimtarisë nuk do të përdoren lëndë kimike të ndaluara me ligj dhe as lëndë ozonholluese.

Duke qenë se veprimtaria është Fabrikë për prodhim të pijeve freskuese dhe të lëngjeve me bazë frutash, duhet vënë në dukje se kjo nuk shkakton zhurma mbi normat e lejuara e si rrjedhim nuk shkakton asnjë lloje ndikimi negativ për shëndetin e njerezve e në veçanti të punonjësve të këtij aktiviteti apo të zonës ku ndodhet ky aktivitet.

6.2. Ndikimet në tokë - Ndotja e tokës në këtë rast karakterizohet me dy fazata ndotjes: faza parë përfshin periudhën gjatë ndërtimit të fabrikës kurse faza e dytë periudhën gjatë procesit të Deponimit dhe Përpunimit të pemëve dhe perimeve. Gjatë fazës ndërtuese ndikim negativ në tokë është paraqitur si rezultat i deponimit të dheut të gërmuar për bazamente, hapja e sipërfaqeve gjelbëruese për ndërtimin e bazamenteve, poashtu efekt negativ kemi edhe nga mbeturinat e ngurta të cilat janë krijuar nga materialet ndërtimore gjatë fazës së ndërtimit, mbeturinat e ngurta komunale të cilat i krijojnë punëtorët. Ndotja mund të vijë edhe nga mbeturinat e lëngëta të cilat shkaktohen nga derdhja e vajrave dhe derivateve të ndryshëm nga mjetet transportuese që transportojnë pemë dhe perime. Gjatë fazës së aktivitetit për prodhim të pijeve freskuese dhe të lëngjeve me bazë frutash ndikime negative në mjedis paraqiten në tokë në këtë mënyrë: Mbetjet e ngurta teknologjike nga pemët dhe perimet të cilat pasi riciklohen në prodhimin e pijeve freskuese dhe lëngjeve me bazë frutash, evadohen menjëherë me mjetet e subjektit për në vedin e caktuar (në gropën e dekompozimit për pleh). Gjatë procesit të përpunimit të Pemëve dhe Perimeve mbetjet e imta në formë të lëngut nuk paraqesin rrezik ndotje, pasi ato shkarkohen në kanalin e ujërave të zeza. Përsa i takon emetimet në ajër, ato përfaqësohen nga shkarkime të papërfillshme gjatë procesit të përpunimit të pemëve dhe perimeve.

- Ndikimet nga mbeturinat e lëngëta të cilat shkaktohen nga derdhja e vajrave dhe derivateve të ndryshëm nga mjetet punuese gjatë furnizimit dhe ndërrimit të

tyre. depozitimi i pluhurave nga mbetjet që krijohet nga proceset teknologjike e poashtu edhe ngjeshja e tokës që vie si pasojë e makinave punuese dhe te tjerave gjatë punës se nevojshme në atë vend.

- Ndikimet negative nga mbeturinat e ngurta të cilat krijohen gjatë procesit të mirëmbajtjes dhe riparimeve të mekanizmave, mbeturinat e ndryshme organike dhe jo organike të cilat i krijojnë punëtorët.

6.3. Ndikimet në ujë

Ndikime negative në ujë shkaktohen:

- Uji mund të ndotet nga derivatet dhe vajrat e ndryshme që rrjedhin në tokë nga makinat e cekura më lartë. Derdhja e vajrave ndikon në ujërat sipërfaqësor e me rastin e të reshurave mund të depërtojnë deri në ujërat nëntokësore. Gjithashtu në ndotjen e ujërave ndikon pluhuri i cili bartet me anë të ujërave sipërfaqësor.
- Ujërat e përdorura në procesin teknologjik për përpunim të pemëve dhe perimeve dhe prodhimin të pijeve freskuese mund të paraqesin dëmtim potencial të ujit, nga acidet dhe bazat e përdorura për të neutralizuar ujin i cili përdoret për prodhimin e pijeve, pastaj nga larja e platosve manipuluese dhe paisjeve teknologjike që përdoret për prodhim të pijeve.
- Nga derdhja e ujërave të zeza,
- Nga mbeturinat metalike të korroduara të cilat janë të depozituara dhe mbeturinat tjera të ndryshme, etj.

6.4. Ndikimi në Peisazh

Lokacioni ku ndodhet fabrika dhe objektet e saj përcjellëse është vend industrial i zhvilluar, andaj për zhvillimin e kësaj veprimtarie është bërë degradim i konsiderueshëm natyror, Fabrika ndodhet brenda parcellave të cilat janë pronë e pronarit z. Shaqir Palushi dhe kanë një infrastrukturë mirë të rregulluar, objektet janë tipe të llojit të fabrikës dhe ka qenë e domosdoshme ndërtimi i tyre për të pasur një funksionim normal fabrika. Gjatë fazës së ndërtimit peizazhi ka pësuar një dëm të konsiderueshëm, mjedis i cili me masat janë ndërmarrë ajo zonë është rregulluar prap

dhe i është kthyer prap një pamje atraktive të një zonë idustriale. Kurse me mbarim të jetë-gjatësisë së projektit, peizazhit do ti kthehet pamja në harmoni me gjendjen e përafërt të mjedisit rrethues. Këto masa do të arrihen me aplikimin e rikultivimit.

6.5. Ndikimi në florë dhe faunë

Për shkak të proceseve operuese që zhvillohen në fabrikë në gjatësinë kohore të operimit dhe në sipërfaqet operuese për rreth fabrikës flora tërësisht është shkatërruar, e cila propozohet të gjelbërohet me aq mundësi dhe hapësirë që të këtë, poashtu domosdoshmërisht duhet të rikultivohet pas përfundimit të punëve prodhuese. Fauna nuk do të dëmtohet fizikisht për arsye se ajo është mobile dhe mund të largohet të zë strehë tjera krahasuar me botën bimore, andaj shtazët janë larguar nga regjioni i veprimtarisë prodhuese dhe do të zhvillohet në terrenin e përafërt që i përshtatet asaj, pa anashkaluar faktin se një pjese të botës shtazore i janë shkatrruar foletë e tyre. Gjatë kohës kur pushon aktiviteti prodhues fauna prapë kthehet për t'u zhvilluar në hapësirat e mëparshme.

6.6. Ndikimet në vendbanime dhe popullatë

Ndikimi negativ në vendbanimet përreth është i vogël, pasi që edhe nuk ka qenë nevoja të bëhet zhvendosja e ndonjë objekti apo ndërtese që të krijohet hapësira e nevojshme për ndërtimin e objekteve. Kjo falë largësisë dhe pozitës së përshtatshme ku ndodhet lokacioni i fabrikës. Zhvillimi i aktiviteti në fjalë në këtë zonë edhe pse jo shumë të zhvilluar në aspektin ekonomik, ka një rëndësi të madhe për popullatën e këtij lokaliteti. Në këtë kompleks të fabrikës “Frutex” shpk në fashtin Novak komuna e Prizrenit është bërë punësimi i një numri të madh të punëtorëve kryesisht nga popullata vendase dhe e rrethinës së Prizrenit dhe Suharekës, nga ana e pronarit të kompanisë “Frutex” shpk, megjithëse mjaftë modest do të ndikojë pozitivisht edhe në ekonomin lokale dhe me gjerë.

6.7. Ndikimet nga Zhurma

Gjatë procesit të grumbullimit, perpunimit të Pemëve dhe Perimeve dhe prodhimit të pijeve freskuese, zhurmat që gjenerohen janë brenda normave të lejuara për këtë lloji teknologjie. Impianti është instaluar në ambiente të mbyllura, objekti është i rrethuar me mur rrethues edhe pse është e distancuar nga shtëpitë e banuara.

Zhurma që gjeneron makina e shtypjes së Pemëve dhe Perimeve është një periudhë kohe të shkurtër, në kohën e sezonit dhe operacionet e tjera janë artizanale, gjenerohen zhurma nga levizja e automjeteve që janë zhurma të zakonshme të makinave, automjetet janë të subjektit dhe do të marrë masa që të jenë të kolauduara dhe brenda kushteve teknike. Zhurma, konsiderohet të jetë një faktor tjetër ndotës, e cila duhet të trajtohet njëjtë sikur faktorët ndotës të tjerë dhe t'i kushtohet një rëndësi e veçantë poashtu. Zhurma vjen si rezultat i aktivitetit të pajimeve për realizimin e procesit teknologjik, gjatë procesit të prodhimit, nga makinat gjatë procesit të transportit, mirëpo për shkak të pajimeve teknologjike dhe atyre transportuese që mirëmbahen dhe funksionaliteti i tyre kontrollohet rregullisht, niveli i zhurmës është nën kufijtë e lejuar me standarde. Me shfrytëzimin e pajimeve prodhuese në bazë të standardeve të caktuara me ligje dhe rregulla të aplikueshme maksimumi i zhurmës në burim është jo shumë i madh por megjithatë nëse kalohet kufiri i kësaj niveli, duhet marrë masa nga ana e pronarit që të minimizohet në maksimum kjo lloj ndotje. Niveli i zhurmës për zonat e banuara në bazë të standardeve ndërkombëtare është i caktuar 50 dB për kohën gjatë ditës, kurse gjatë natës niveli i zhurmës duhet të jetë max. 45 dB. Në vijim po e paraqesim në formë tabelore nivelin e zhurmës në varshmëri nga distanca.

Zhurma	Distanca (m)			
	10	50	100	500
90db -niveli Për pajisje moderne	59	45	39	25

Në bazë të vlerave të paraqitura në tabelë dhe duke pasur parasysh distancën e objekteve të banimit si dhe kapacitetin e pajimeve dhe numrin e mjeteve transportuese që nevojiten për realizimin e procesit teknologjik, si dhe duke pasur parasysh se fabrika

duhet të punoj vetëm ditën, mund të konkludojmë se fabrika nuk ka ndikime negative në njerëzit që banojnë dhe veprojnë në rrethin e saj.

6.8. Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore

Pasi që aktiviteti i fabrikës për prodhim të pijeve freskuese dhe të lëngjeve me bazë frutash dhe pajimet tjera përcjellëse janë mirë të projektuara, të vendosura dhe të monitoruara nga persona përkatës për këtë punë, pastaj veprimtaria në fjalë nuk funksionon me materie të rrezikshme për mjedisin, konkludojmë që aksidente mjedisore të mëdha nuk mund të ndodhin. Aksidentet të cilat mund të ndodhin, mund të jenë të natyrës së ndryshme dhe mund të ndodhin në çdo kohë gjatë realizimit të procesit teknologjik si:

- Nga rrjedhjet e ndryshme të lëndëve djegëse dhe lubrifikuese.
- Nga mekanizmi punues, derdhja e kimikateve që përdoren në proces teknologjik.
- Nga mundësia e pëlcitjes së gypave hidraulik dhe atyre të ujit.
- Mundësia e përfshirjes nga flaka e ndonjë reparti të caktuar.
- Nga aksidentet e mundshme në komunikacion gjatë transportit
- Nga aksidentet e mundshme në komunikacion gjatë kycjes së automjeteve transportuese nga fabrika në rrugën kryesore.
- Nga aksidentet e mundshmenë rast të vërshimeve eventuale, sepse pranë fabrikës kalon edhe një rrejedhë uji.

7.0. MARRJA E MASAVE PËR PARANDALIMIN DHE ZVOGËLIMIN E NDIKIMEVE

7.1. Masat e marura për mbrojtjen e ajrit

Për të parandaluar apo zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në ajër të cilat i kemi cek më lart duhet të merren këto masa:

- Pluhuri i cili lirohet gjatë procesit teknologjik të prodhimit apo transportimit duhet të mënjanohet apo zvogëlohet gjerë në kufijtë e lejuar.

- Për mënjanimin dhe zvogëlimin e sasisë së pluhurit kompania duhet të instaloj sistemin e filtrave sipas nevojës, ventilimin dhe ajërimin e gjithë hapësirës së mbyllur.
- Duhet berë instalimin e sistemit të ujit për sperkatjen dhe pastrimin e sipërfaqeve manipuluese operationale.
- Duhet të behët kontrollimi i rregullt teknik i automjeteve transportuese që konsumojnë lëndë të lëngëta djegëse me qëllim që lirimi i gazrave nga automjetet e lartë cekura të jetë sa më kualitativ.
- Duhet të largohen vazhdimisht mbeturinat e pemëve dhe përmive të kalbura apo shurupave të prishur, të cilët lirojnë aroma të pagëndshmë, sepse mund të kundërmojnë puntorët dhe popullatën për rreth.

7.2. Masat e marura për mbrojtjen e tokës

Për të parandaluar dhe zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në tokë gjatë fazës së veprimit të fabrikës të merren këto masa:

- Gjatë fazës së ndërtimit të impiantit apo të ndonjë reparti tjetër, dheu i gropuar duhet të shfrytëzohet për rrafshimin, planifikimin e terenit i cili duhet të mbillet, pjesa tjetër e dheut duhet të dërgohet në deponin regjionale.
- Mbeturinat e ngurta komunale të grumbullohen, klasifikohen dhe të vendosen në kontejnerë të posaçëm të pajisur me kapak për mbulim, kontejnerët duhet të sigurohen për deponimin e të gjitha llojeve të mbeturinave të klasifikuara ne bazë të rregullave dhe kushteve të përcaktuara me Ligj të mbeturinave, pas mbushjes së kontejnerëve përmes ndërmarrjeve për menaxhimin e mbeturinave, këto mbeturina të dërgohen në deponin e qytetit.
- Ujërat e shkarkimit të mos, hudhën në lumë apo në sipërfaqe të hapura pa u bërë partrajtimi i paraprak i këtyre ujërave.

- Vaji i makinave ngarkuese dhe transportuese që nevojiten për operimin e fabrikës të ndërrohet në vende të caktuara dhe të izoluara për mos depërtimin e tyre në tokë, vajrat e përdorura duhet të deponohen në enë të posaçme, dhe pastaj t'u dorëzohen ndërmarrjeve të licencuara për grumbullimin e vajrave të përdorura. Për të parandaluar e zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në tokë gjatë fazës së operimit të fabrikës duhet të merren këto masa:
- Duhet të merren masat e nevojshme për mos lëshuarjen e pa kontrolluar të derivateve dhe vajrave nga makinat dhe pajimet prodhuese.
- Të bëhet betonimi izolimi i secilës plato ku janë të vendosura pajimet për prodhim dhe sipërfaqet tjera operationale.
- Të gjitha mbeturinat e ngurta të cilat krijohen në lokacionin e fabrikës duhet të grumbullohen dhe klasifikohen sipas përbërjes dhe llojit të tyre, ato metalike të deponohen në vende të posaçme, ato të cilat nuk përdoren për nevoja të kompanisë ti shiten kompanive të licencuara.
- Mbeturinat e ngurta komunale të grumbullohen dhe vendosen në kontejner të posaçëm të pajisur me kapak për mbulim, me transport vetanak apo nëpërmjet ndërmarrjeve për menaxhimin e mbeturinave, këto mbeturina të dërgohen në deponin regjionale.
- Sipërfaqet jo funksionale të mbjellën me bimë gjelbëruese, si dhe të mbillen drunj dekorativ gjith mbajtës.

7.3. Masat e marura për mbrojtjen e ujit

Për të parandaluar e zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në ujë të cilat i kemi cekë më lart duhet ndërmarr këto masa:

- Në lokalitetin e kompleksit të fabrikës duhet të bëhet sistemi për grumbullimin dhe trajtimin të ujërave, pastaj bartjen e ujërave të ndotura të krijuara nga procesi i pastrimit të frutave, procesi i prodhimit, nga larja e automjeteve transportuese, ujërave nga të reshurat atmosferike, etj.

- Ujërat e përdoruar në proces teknologjik nuk duhet të përzier më ujërat atmosferike apo ujërat e lajës.
- Mirembajtja dhe kontrolli i vazhdueshëm i rrjetit të kanalizimeve të fabrikës deri në nyen lidhese me kanalin kullues të parceles së kompanisë.
- Duhet rregulluar sistemin gypor për bartjen e ujërave të ndotura të cilat duhet të dërgohen për trajtim në puse sedimentuese (impiantë) për pastrimin e ujërave të ndotur me grimca të ngurta.
- Kolektorët duhet të rregullohen në pozicionet e caktuara me qëllim që të tërë sasia e ujërave industriale dhe e të reshurave atmosferike dhe nga tëra sipërfaqet funksionale të grumbullohen dhe të orientohen në puset sedimentuese e pastaj në seperator.
- Seperator duhet të rregullohet në atë mënyrë që të mundë të kontrollohet rregullisht uji i cili pastrohet dhe të merren mostrat e ujit i cili pastrohet.
- Ujërat e zeza duhet së pari të trajtohen në gropën septike e cila duhet të ndërtohet në varshmëri me numrin e punëtorëve, dhe pas trajtimit të lëshohen në recipient të pastërta.
- Gropa septike duhet të pastrohet nga kompanitë e licencuara.

7.4. Masat për mbrojtjen e florës dhe faunës

Bazuar në hulumtimet e bëra në terrenin ku ndodhet fabrika kemi cekur se do të jetë e afektuar edhe flora edhe fauna egzistuese karakteristike e këtij lokacioni. Mirëpo në lokacionin në fjalë nuk kemi zhdukje masive të vegjetacionit apo të ndonjë lloji endemic, e njëjta vlen edhe për faunën që do të thotë se nuk pritet të ketë ndikime negative në atë aspekt të zhdukjes së ndonjë lloji të veçant apo endemic, për më tepër kur fauna ka aftësinë e mobilitetit. Kompania nuk duhet të deponoj pa kontroll mbeturina në vende të ndryshme por ato duhen të deponohen në vende me destinacion të caktuar. Duhet të minimizoj në mënyrë strikte masën e pluhurit që mund të vijë nga aktiviteti në fabrikë. Në raste të lajmërimit të zjarrit menjëherë të merren masa për neutralizimin e tij në mënyrë që të mos dëmtohet bota bimore. Pajisjet kundër zjarrit

duhen të ruhen në mënyrë të veçantë. Për mbrojtjen e botës shtazore kompania duhet të tregoj kujdes duke kufizuar lëvizjet e të punësuarve jashtë zonës operuese dhe të kenë kujdes në nivelin e zhurmës, kualitetin e ajrit, ujit, etj.

7.5. Masat e marura për mbrojtjen nga zhurma

Për të parandaluar dhe monitoruar dëmin e shkaktuar nga zhurma, duhet të bëhen matjet e zhurmës në përputhje me ligjet dhe rregullat mbi mbrojtjen nga zhurma. Matjet zakonisht bëhen në afërsi të objekteve të banimit për arsye se banorët në afërsi nuk duhet të shqetësohen nga zhurmat e krijuara nga kjo veprimtari. Për vlerësimin e rezultateve të fituara nga matjet duhet ti krahasojmë me vlerat e lejuara me standarde për vendet ku jetojnë dhe punojnë njerëzit. Në raste se zhurma e mesit nga matjet tejkalon atë të lejuarën atëherë duhet të merren të gjitha masat që niveli i zhurmës të bihet në nivelin e lejuar sipas rregullave në fuqi. Në varshmëri nga fazat e procesit të punës duhet edhe të punësuarit në ato vende të punës të përdorin mjete mbrojtëse kundër zhurmës.

7.6. Masat e marura për mbrojtjen nga rreziqet aksidenciale

Duhet të bëhet plani i intervenimit për raste të aksidenteve ekologjike. Duhet të bëhet plani i mbrojtjeve nga zjarri. Duhet i tërë oborri i fabrikës të thuret me mur nga betoni me qëllim të marrjes së masave të sigurisë ndaj vërshimeve eventuale. Të merren të gjitha masat për evitimin e derdhjes së ujëravë të ndotura, lengjet e prishuar dhe të derivateve të naftës dhe vajit nga makinat transportuese dhe ngarkuese si dhe pajimet tjera. Të merren të gjitha masat e sigurisë konform ligjit për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të punësuarve dhe mjedisit të punës.

8. Programi i Monitorimit

Programi i monitorimit do të konsistoi në kontrollin e vazhdueshëm e rigoroz të parametrave të procesit teknologjik të punës në instalimin e prodhimit të pijeve freskuese dhe të lëngjeve me bazë frutash. Për këtë do të ekzistoi një dokumentacinë i

plotë teknologjik, si rregulloret, udhezimet, etj dhe dokumentat ditore, ku do të shënohet zbatimi i tyre.

Bazuar në vlerësimet e ndikimit në mjedis, ndikimet direkt nga aktiviteti i fabrikës e cila si veprimatrti kryesore ka prodhim të pijeve freskuese dhe të lëngjeve me bazë frutash, pra ndikim mund të ketë në tokë, ajër dhe ujë. Këto ndikime janë relativisht të vogla në mjedisnëse merren masat për zvogëlimin e këtyre ndikimeve, dhe si të tilla mund të monitorohen. Andaj për këtë arsye parashihet një program monitorues për të gjitha shkarkimet dhe dëmtimet që mund të ndodhin nga aktiviteti i kësaj fabrike. Monitorimi i ajrit dhe ujit duhet të bëhet me marrjen e mostrave dhe kryerjen e analizave në institute adekuate dhe të raportohen në Ministri sipas kërkesës së tyre.

Siç u pasqyrua më lartë për të patur ne kontroll të vazhdushem efektët e ndikimeve të shkakrimeve ne ajer ,toke dhe uje është e nevojshem të realizohet nje plan monitorimi i cili do të përfshije kontrollin cilesor jo vetëm të komponentëve dhe produktëve, por edhe të cilesise se mjedisit qe përfshin ky aktivitet.

Ky plan monitorimi përfshin:

1. Analizat cilesore të ujit të pishem qe përdoret për prodhimin e ujit të shkripezuar.
2. Të bëjë matjen e pH së ujrave qe shkarkohen te jete ne vlerat 6 – 8.
3. Analizat e ujrave të shkarkimit të larjes se pajisjeve. Kjo analize do të përfshije matjen e tëmpëratures dhe vleres se pH të ujrave të shkarkimit.
4. Analiza e gazeve të djegjes se kaldajeve për përcaktimin e CO, SO2, Nox dhe tëprices se O2.
5. Kontrolli i cilesise se Gazit të lëngët për të garantuar normat e lejuara të shkarkimit të gazeve.

Kryerja e ketyre analizave krahas ndjekjes se prodhimit dhe cilesise se tij ndihmojne për të kontrolluar ndikimin ne mjedis të ketij aktivitetit i cili sic theksuam edhe me sipër ka nje efekt të vogel.

9. Raportimi

Raportimi duhet bërë në mënyrë periodike nga ana e udhëheqësve, gjegjësisht nga përgjegjësit e kompanisë “Frutex” shpk së paku në fund të çdo viti kalendarik, ku do ti

paraqiten të dhënat relevante nga të gjitha monitorimet e bëra brenda vitit, të cilat do të raportohen në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor sipas kërkesës së tyre si dhe sipas kërkesave dhe rekomandimeve të legjislacionit në fuqi dhe komunitetit lokal brenda komunës.

10.MARJA E MASAVE REHABILITUESE PAS PËRFUNDIMIT TË AKTIVITETEVE PRODHUESE

Pas përfundimit të veprimtarisë së fabrikës, e kjo varet nga vjetërsia e pajimeve dhe nga pronari se a do të vazhdoj me këtë projekt me blerjen e pajimeve të reja apo do të përfundoj aktivitetin për prodhim të pijeve freskuese dhe të lëngjeve me bazë frutash. Pas afatit të përfundimit të aktivitetit prodhues, pajimet duhet të çmontohen dhe në bazë të levërdisë së kompanisë të shitën si material i vjetruar. Bazamentet si dhe platot nga betoni duhet të shkatërrohen, imtësohen dhe të dërgohen në deponi të qytetit. Si rezultat i punës nga aktiviteti teknologjik i prodhimit do të krijohen substrate që i takojnë kategorisë së tokave të dëmtuara d.m.th. substrate të pa përshtatshme (sterile) për rikultivim. Substrate me përmbajtjes të gurit gëlqeror, rërës, zhavorri dhe betoni, etj. që pa tjetër duhet të largohen dhe të bëhet zëvendësimi, me një shtresë të humusit prej 0,5 m trashësi të analizuar nga aspekti agrokimik, pastaj duhet të bëhet ngjeshja e e kësaj shtrese të humusit (dheut) me qëllim që të jetë shtresa ma kompakte, ashtu qe të krijohet një substrat produktiv i përshtatshëm për rikultivim. Rikultivimi i këtyre sipërfaqeve të dëmtuara përfshin rivitalizimin në tërësi të hapësirave të dëmtuara nga realizimi i projektit. Zgjedhja e modelit të rikultivimit varet nga: Qëllimi i rikultivimit i cili nënkupton që pas përfundimit të punëve në procesin teknologjik, sipërfaqeve të degraduara, prapë t'u kthehet funksioni i saj primar (prodhimi i biomasës), dhe kështu zvogëlohet ndikimi negativ i këtij projekti në ekosistem. Planifikimi i shfrytëzimit të tokës, planifikohet që toka në lokacionin e Fabrikës të kthehet në gjendje të përafërt me ambientin rrethues dhe të mbillen bimë të cilat kanë qenë më parë të mbjellur para degradimit, apo lloje të nejta me habitatin rrethues.

11. Konkluzionet

Fabrikë për prodhim të pijeve freskuese dhe të lëngjeve me bazë frutash “Frutex” shpk në fshatin Novak komuna e Prizrenit është një nga fabrikat me moderne e prodhimit të lëngje të frutave dhe pijeve freskuese (pijeve energjike) në vendin tonë. Zgjedhja e teknologjisë moderne sipas standardeve të fundit të prodhimit i siguron asaj jo vetëm një produkt cilesor me një ndikim shumë të rëndësishëm ekonomik por e bënë atë një aktivitet miqësor me mjedisin ku kjo fabrikë është ngritur. Objektet ku kompania „Frutex” shpk ushtron aktivitetin e saj të përpunimit, prodhimit dhe deponimit në aspektin ndërtimor, plotëson kërkesat për një aktivitet të tillë prodhuës.

Ndikimi i Fabrikë për prodhim të pijeve freskuese dhe të lëngjeve me bazë frutash nga aktiviteti prodhues i kompanisë **“Frutex” Sh.p.k.** me lokacion në fshatin Novak komuna e Prizrenit në mjedisin rrethues është në nivelin e vlerave të standardeve të caktuara me ligjet dhe aktet nënligjore të aplikushme. Ndikimi në tokë, ajër dhe ujë, nuk mungon por mund të kontrollohet dhe të minimizohet deri në vlerat referente të lajuara sipas Ligjit. Këto ndikime do të monitorohen dhe do të raportohet në mënyrë të saktë në fund të çdo viti kalendarik, sipas kërkesës së Ministrisë së Mjedisti dhe Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës.

Bazuar në të gjitha elementet e shtruara në këtë raport mund të konkludohet se Fabrikë për prodhim të pijeve freskuese dhe të lëngjeve me bazë frutash në këtë lokalitet dhe teknologjin e përdorur gjatë prodhimit, duke garantuar në cilësinë dhe kapacitetit të tij prodhues, nuk ka potencial të rrezikimit të shëndetit të njerëzve (për më tepër kur nuk ka pas as ankesa nga ana e banorëve të kësaj rrethine më të afërt, qoftë për ujë, ajër, pluhur apo zhurmë) dhe të mjedisit nëse zbatohen të gjitha masat mbrojtëse të rekomanduara në këtë raport. Gjithashtu ndikimet në tokë, ujë, ajër dhe peizazh, pas identifikimit dhe zbatimit të të gjitha masave mbrojtëse të rekomanduara do të jenë minimale. Nga ana e drejtuesve të fabrikës niveli i lartë i teknologjisë së instaluar është e shoqëruar me një ambient të jashtëm mjaft atraktiv duke e bërë atë funksionale dhe mjaft të pranueshme në mjedisin human ku kjo fabrikë kryen aktivitetin. Mendojmë se këto të dhëna janë të mjaftueshme dhe i mundësojnë MMPHI-së për dhënien e

mendimit për Pëlqim Mjedisor sipas kërkesës së pronarit të kompanisë „**Frutex**” **Sh.p.k**, me pronar **z. Shaqir Palushi** nga fshati Novakë komuna e Prizrenit.

Skema 3. Teknologjia e trajtimit të ujit

